



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në mbështetje të nenit 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18) dhe nenit 68, paragrafi 1, pika 1 të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16 dhe 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut mori:

V E N D I M

për ndryshimin e Vendimit për metodologjinë e menaxhimit të rreziqeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 314/20)

1. Në Vendimin për metodologjinë e menaxhimit të rreziqeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 113/19 и 69/20), në pikën 20, paragrafi 3, fjalët: "shkallët e likuiditetit" zëvendësohen me fjalët: "shkalla e mbulimit me likuiditet ose treguesit e brendshëm të likuiditetit".

2. Në shtojcën nr. 9, në pikën 1, paragrafi 1, fjalët: "rregullorja e Bankës Popullore për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit" zëvendësohen me fjalët: "rregullorja e Bankës Popullore për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit".

Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"Banka është e detyruar të vendosë një proces të identifikimit të rreziqeve që kanë ose mund të kenë ndikim në likuiditet, e më pak në aktiven likuide, hyrjet dhe daljet e mjeteve monetare, strukturën e maturimit të aktives dhe të pasive, burimet e mjeteve dhe përqendrimin e tyre dhe mundësinë e përdorimit të mjeteve në dispozicion të bankës, pa kufizime si kolateral për fitimin e burimeve shtesë të mjeteve, në kushte normale dhe të jashtëzakonshme funksionimi".

Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

"PIL duhet të sigurojë identifikimin dhe monitorimin e pozicioneve në valuta që konsiderohen si materiale për likuiditetin e bankës (për shembull, pozicionet në valuta të rëndësishme, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit), si në kushte normale, ashtu edhe në kushte të jashtëzakonshme pune. Në aktet e veta të brendshme, banka duhet të përcaktojë mënyrën e përcaktimit të valutave që konsiderohen si materiale për likuiditetin e bankës, si dhe të përcaktojë mënyrën e monitorimit të pozicioneve në secilën prej këtyre valutave".

Në pikën 10, paragrafi 1, fjala: "ekzistencë" zëvendësohet me fjalën: "ndodhja".

Në pikën 12, paragrafi 1, fjalët: "dhe për maturimin e pritshëm", zëvendësohen me fjalët: "mënyra se si monitorohet letra me vlerë në dispozicion të bankës dhe që mund të përdoret për të fituar burime shtesë të mjeteve", ndërsa pas fjalëve: "qëndrueshmëria e burimeve të mjeteve", shtohen fjalët: "dhe rinovueshmëria e tyre".

Në pikën 13, paragrafi 1, fjalët: "rregullorja e Bankës Popullore për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit" zëvendësohen me fjalët: "rregullorja e Bankës Popullore për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit".

Në pikën 16, paragrafi 1, nënparagrafi 1, fjalët: "shkallët e likuiditetit" zëvendësohen me fjalët: "shkalla e mbulimit me likuiditet", ndërsa fjalët: "rregullorja e Bankës Popullore për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit" zëvendësohen me fjalët: "rregullorja e Bankës Popullore për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit".

Në pikën 16, paragrafi 1, nënparagrafi 2, fjalët: "rregullorja e Bankës Popullore për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit" zëvendësohen me fjalët: "rregullorja e Bankës Popullore për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit".

Në pikën 18, paragrafi 1, fjalët: "dhe t'i arsyetojë" fshihen.

Në pikën 18, paragrafi 2, fjalët: "shkallët e likuiditetit, raporti", zëvendësohen me fjalët: "shkalla e mbulimit me likuiditet, shuma", ndërsa fjalët: "ditën e zbatimit të" zëvendësohen me fjalët: "fillimi i periudhës të cilës i referohet".

Në formularin "Raport për PIL", i cili është pjesë përbërëse e shtojcës nr. 9, në shpjegimin nën tabelën nr. 5, fjalët: "shkalla e likuiditetit" zëvendësohen me fjalët: "shkalla e mbulimit me likuiditet".

Në formularin "Raport për PIL", i cili është pjesë përbërëse e shtojcës nr. 9, tabela nr. 6 dhe shpjegimi më poshtë në tabelë ndryshohen si më poshtë:

"6. Krahësimi i likuiditetit të brendshëm dhe likuiditetit aktual

(Data)*	Likuiditeti aktual**	Likuiditeti i brendshëm***
Pjesa 1. Shkalla e mbulimit me likuiditet		
Pjesa 2. Treguesit e likuiditetit të brendshëm ****		
...		
Pjesa 3. Mënyrë tjetër për të shprehur likuiditetin e brendshëm *****		

* Banka shënon datën të cilës i referohen të dhënat në tabelë (për shembull, fundi i vitit që i paraprin vitit të cilit i referohet raporti i PIL).

** Pjesët 1 dhe 2 të tabelës duhet të plotësohen patjetër, ndërsa në pjesën e dytë banka shënon të gjithë treguesit e likuiditetit që ka përcaktuar, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit. Pjesa e tretë plotësohet vetëm nëse banka përdor mënyrë tjetër për të shprehur likuiditetin e brendshëm.

*** Banka vë vlerësimin e nevojave aktuale dhe të ardhshme për mjete likuide dhe burime të qëndrueshme të mjeteve. Plotësohet vetëm pjesa e tabelës (1, 2 ose 3) që korrespondon me mënyrën se si banka shpreh likuiditetin e brendshëm.

**** Banka shënon të gjithë treguesit që përdor për qëllime të shprehjes dhe përcaktimit të likuiditetit të brendshëm (nëse është e nevojshme shtohen rreshtat).

***** Banka arsyeton mënyrën e shprehjes së likuiditetit të brendshëm.”

Në formularin “Raport për PIL”, i cili është pjesë përbërëse e shtojcës nr. 9, tabela nr. 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. PIL si pjesë e sistemit të bankës për menaxhimin e rreziqeve

Planifikim dhe ndjekje të hyrjeve dhe daljeve të mjeteve monetare (shënohen kriteret mbi bazën e të cilave përcaktohen hyrjet dhe daljet aktuale dhe të ardhshme (të pritshme) të mjeteve monetare, si dhe koha që do të nevojitej për të ndërruar mjetin e caktuar në hyrje monetare; përshkruan kriteret dhe instrumentet për matjen dhe monitorimin e nevojave për likuiditet ditor)
Vendosje dhe mirëmbajtje e strukturës së duhur të maturimit (shënohen kriteret e vendosjes dhe të mirëmbajtjes së strukturës së duhur të maturimit të pozicioneve në aspekt të harmonizimit të tyre sipas maturimit të mbetur, si dhe supozimet në bazë të të cilave përcaktohet maturimi i mbetur i pritshëm, seria kohore e përdorur për të përcaktuar maturimin e pritshëm të hyrjeve dhe të daljeve monetare, data e rishikimit të fundit të supozimeve dhe arsyeja e rishikimit, mënyra e grupimit të hyrjeve dhe daljeve të veçanta për qëllime të përcaktimit të maturimit të mbetur të pritshëm)
Ndjekje e burimeve të mjeteve dhe përqendrimi i tyre (përshkrimi i burimeve më të rëndësishme të mjeteve, sipas depozituesit, llojeve të instrumenteve, përkatësisht produktet, tregu, vendi, valuta etj.; kriterëve të përcaktimit të shkallës së stabilitetit të burimeve individuale të mjeteve; mënyrës së ndjekjes së diversifikimit të burimeve të mjeteve dhe kontrollit të përqendrimit në burimet e mjeteve; kriterëve të ndjekjes së çmimit të burimeve të mjeteve dhe të maturimit të tyre; vlerësimit të mundësisë së rinovimit të burimeve të mjeteve; vlerësimit të mundësisë së transferimit të mjeteve likuide ndërmjet anëtarëve të grupit, nëse banka i përket një grupi brenda ose jashtë vendit)
Kolateral që mund të përdoret për nevojat e likuiditetit (shënohen mjetet/kolaterali në dispozicion të bankës që mund të përdoren si kolateral për fitimin e burimeve shtesë të mjeteve; vlerësohet mundësia/rreziku i përdorimit të këtyre burimeve në aspekt të periudhës kohore të aktivizimit të tyre apo ndonjë ngjarje tjetër që mund të kufizojë përdorimin e tyre)
Plan i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit në kushte të jashtëzakonshme (paraqitet plani i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit në kushte të jashtëzakonshme ose shënohen ndryshimet që banka ka bërë në plan, në lidhje me planin e paraqitur në vitin e kaluar)

Strukturë organizative (shënohen organet, njësitë organizative dhe personat e përfshirë në vendosjen dhe zbatimin e PIL, së bashku me kompetencat e tyre dhe linjat e raportimit në lidhje me PIL)
Sistem i raportimit (lista e raporteve që përpilohen për nevojat e PIL, organet/personat në bankë të cilëve u dorëzohen këto raporte dhe shpeshtësia e përpilimit dhe e dorëzimit të raporteve)
Auditim i brendshëm dhe i jashtëm (përshkrimi i vlerësimit të fundit të PIL nga Shërbimi i auditimit të brendshëm: kur u bë, cili ishte qëllimi dhe cilat ishin përfundimet dhe gjetjet) (përshkrimi i vlerësimit të fundit të PIL nga auditori i jashtëm: kur u bë, cili ishte qëllimi dhe cilat ishin përfundimet dhe gjetjet) (masat e marra në bazë të gjetjeve të auditimit të brendshëm dhe/ose të jashtëm dhe kush është përgjegjës për marrjen dhe monitorimin e masave të ndërmarra)

Banka jep përgjigje të hollësishme ndaj pyetjeve të përfshira në tabelë".

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa do të fillojë të zbatohet më 1 janar 2021.

V nr. 02-15/XVIII-1/2020
dhjetor 2020
Shkup

Guvernatorja 28
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska